



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 68 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 17 / 04 / 2025

VENDIM
Nr.14, datë 17 /04 /2025

PËR

LISTEN E DIGAVE TË VOGLA PËR VITIN 2025 ME RREZIKSHMËRI PËR TË TRETËT

Në mbështetje të Ligjit Nr.8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", si dhe VKM Nr. 278, datë 08.05.2003 "Për Miratimin e Rregullores së funksionimit të KKDM dhe KTPD", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 17.04.2025 mori në shqyrtim çështjen e listës së digave/dambave të vogla me rrezikshmëri për të tretët që duhet të jenë objekt i veprimtarisë së KKDM në të ardhmen duke patur paraysh jo vetëm lartësinë e saj apo volumin e rezervuarit të krijuar por edhe shkallën e rrezikshmërisë që ato paraqesin për të tretët në rast të prishjes së digës apo vlerat ekonomike të tyre. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Ti kërkojë KTPD dhe ITD të hartojnë listën e digave/dambave për vitin 2025 që do të jenë objekt i veprimtarisë së KKDM në të ardhmen sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Kriteria themelore për hartimin e kësaj liste do të shërbej shkalla e rrezikshmërisë që ato paraqesin për të tretët në rast prishje si dhe vlerat ekonomike të dëmeve që mund të shkaktojnë. Kjo listë do të bazohet në listën e digave dhe rezervuarëve të përgatitur nga MBZHR gjatë procesit të kalimit të infrastruktures ujore dhe aseteve të paluajtshme të kësaj infrastrukture sipas kërkesave të VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015, në informacionet e marra nga raportet vjetore për vitin 2024 të shfrytëzuesve aktualë të këtyre digave (Bashkitë), si dhe në gjëndjen aktualë në terren. KTPD do të mbështetet në këtë proces nga SKDM në komunikimin me institucionet që mbulojnë dhe administrojnë diga/damba, me shfrytëzuesit aktual të digave dhe marrjen e informacionit të duhur për të gjitha digat që janë më të vogla se 15 m, me gjatësi të kurorës së digës me pak se 500 m dhe me rezervuar uji me volum më të vogël se 1 milion m³ por që përbëjnë rrezik për të tretët të cilët janë faktorë që ndodhen në pjesën e poshtme të digës/dambës. Në këtë listë përveç emërit të digës dhe bashkisë që e administron duhet të jepen të paktën edhe të dhënat kryesore të saj sic janë lartësia e digës, gjatësia e kurorës, koha e ndërtimit të saj, njerëzit në rrezik, etj
- 2- SKDM të përgatitë arkiven e pasaportave të digave të përcaktuara në këtë listë sipas udhezimit të KKDM të miratuar me vendimin Nr. 02, datë 21.09.2020 brenda vitit 2025.
- 3- KTPD dhe ITD duhet të përgatit një raport për KKDM në lidhje me listen e digave të kerkuar në pikën 1 të këtij Vendimi brenda muajit Qershor 2025.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe ndjekjen e detyrave të dhëna në këtë vendim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI
Arjan JOVANI

